

KONTRIBUT ME VLERË PËR HISTORIOGRAFINË DHE PUBLICISTIKËN SHQIPTARE

(Ardian Limani, Anton Panchev, “*Bullgarët dhe serbët në artikujt e gazetës “Shkupi” (1911-1912)*”, Instituti për Politika Publike “Arbën Xhaferi”, Shkup, 2023, f. 272)

Botimi i artikujve të gazetës shqiptare “Shkupi” përgjatë viteve 1911-1912 që flasin për bullgarët dhe serbët, përbën kontribut të rëndësishëm për të kuptuar më mirë ecurinë e zhvillimeve politike në vilajetin e Kosovës, shteteve fqinje si Bullgaria, Serbia por edhe Perandorisë Osmane, e cila ishte në ditët e saj të fundit. Autorët Ardian Limani dhe Anton Pançev janë tanimë të njohur para opinionit studimor për saktësinë e tyre shkencore në trajtimin e shumë fenomeneve historike nga Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe raportet e tyre me shtete si Bullgaria por edhe Serbia. Në këtë aspekt ata plotësuan një zbrazëti për lexuesin dhe historiografinë shqiptare duke e ofruar para tyre këtë libër me vlerë shkencore.

Në kontekstin historik autorët i kanë dhënë edhe rrethanat politike ku u zhvillua dhe u rrit shtypi shqiptar pas vitit 1908 në territorin e Maqedonisë së Veriut. Së këndejmi përmenden gazeta me peshë si “Bashkimi i Kombit”, “Kalendari Afërdita”, “Drita” etj. Por, opusin publicistik më të rëndësishëm në këtë kohë e dha padyshim publicisti Jashar Erebara, i cili ishte një erudit dhe patriot shqiptar. Ky sipas autorëve nisi botimin e gazetës “Shkupi” më 1911. Gazeta kaloi në vështirësi të shumta pasi zhvillimet politike që nga viti 1908 në vendet e sunduara nga Perandoria Osmane ishin të brishta dhe kësaj veprimtaria e kësaj gazete ishte e kushtëzuar nga shumë rrethana, porse ajo megjithatë luajti një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e çështjes shqiptare përgjithësisht. Për të kuptuar më mirë rolin e Jashar Erebarës, autorët janë kujdesur që të japin të dhëna interesante për jetën dhe veprën e tij ndër vite.

Në të mund të shihet veprimtaria e tij publicistike më e hershme duke filluar nga fundi i shekullit XIX, pastaj nga vitet 1901-1906 në Beograd me nxjerrjen e gazetës “Albanija” etj. Autorët konstatojnë se u zgjodh Shkupi si kryeqendër e vilajetit të Kosovës, që të themelohet kjo gazetë më 1911 mu në vllugun e zgjidhjes së çështjes shqiptare dhe ashpërsimit të rrethanave politike nga fqinjët grekë dhe serbë të cilët ishin në funksion të ideve megalomëdha për gllabërimin e tokave shqiptare.

Gazeta mbuloi tema të ndryshme dhe redaksia e saj u përkujdes që të trajtoheshin çështje shoqërore dhe politike për kohën. Erebara, sipas autorëve, ishte ideatori kryesor që të hartohet edhe abetarja e njohur me emrin “Abetarja e Kumanovës”, e cila në fakt ishte një shtojcë për gazetën “Shkupi”. Synimi kryesor ishte përhapja e shkrimit shqip në mesin e shqiptarëve dhe jetësimi i vendimeve të Kongresit të Manastirit. Në shtojcën e këtij libri me vlerë shohim edhe një pjesë me vlerë e cila titullohet “Paraqitja e bullgarëve dhe serbëve në artikujt e gazetës “Shkupi” të analizuara nga autorët e kësaj vepre. Gazeta “Shkupi” u kujdes që të ofronte informacione për lexuesin dhe të pasqyronte para opinionit planet e shteteve fqinje, ndër to, Bullgarinë e Serbinë.

Në mesin e këtyre shohim edhe tema me interes të cilat shpërfaqnin pamundësinë e afrimit ndërmjet Serbisë dhe Bullgarisë në planin politik. Vërehet qartë që autorët kanë identifikuar me kujdes artikujt të cilët bëjnë fjalë edhe për memorandumet e bullgarëve brenda territorit të Maqedonisë, ku ata kishin përpiluar shkresa dhe duhej që të dërgoheshin për konsujt e shteteve evropiane për padrejtësitë e Perandorisë Osmane ndaj banorëve të Maqedonisë. Në shkrimet e shumta shohim edhe tituj që flasin për partinë Xhemijeti. Gazeta “Shkupi” sugjeroi se në këto shkrime të kenë kujdes shqiptarët, sepse serbët e inkuadruar në këtë parti mund të bëjnë kërdinë me dinakërinë e tyre. Pos kësaj në këto shkrime shprehej besimi se politika e Evropës do ta shpëtonte Maqedoninë nga tirania e Perandorisë Osmane. Për të parë më qartazi rolin e Bullgarisë mbi popullatën e tyre në arealin e Maqedonisë kemi edhe shkrime ku ushtria bullgare priste shkaqe më të forta të kalonte kufirin dhe të mbronte popullatën e saj. Shkrimet e gazetës “Shkupi” për bullgarët na tregojnë qartazi se ajo kishte kontradikta të mëdha me Serbinë në planin politik dhe nuk mund të bashkëpunonte me të kurrësesi, sepse interesat e tyre nuk përputheshin fare. Kurse me Perandorinë Osmane

kishin mospajtime për shkak të shtypjes së popullatës së saj, e cila emërtohej me termin maqedonas sipas territorit. Autorët me kujdes kanë zbërthyer edhe tekstet që bëjnë fjalë edhe për serbët në faqet e kësaj gazete. Në të shohim tituj të ndryshëm ku përmendet edhe Kosova. Jepet një pasqyrim historik për Kosovën dhe kontekstin historik të këtij vendi.

Me një objektivitet të thukur “Shkupi” në shkrime si “Serbët osmanli dhe propaganda e Serbisë” tregohet qartazi se serbët osmanli banorë në Maqedoni ishin kundër propagandës serbe dhe gazetës “Vardar”, të cilët shprehnin propagandën e “Serbisë së Madhe”. Nga shkrimet më interesante ndeshim edhe atë me titull “Serbia dhe Shqipëria”. Shkrimi në formë kronike na tregon edhe vrasjet e mizoritë serbe ndaj shqiptarëve duke filluar nga shekullit XIV. Shkrimet e tilla pasqyrojnë objektivisht mentalitetin e serbëve dhe barbarinë e tyre. Libri i autorëve, pos tjerash mund të shërben edhe për plotësimin e shumë librave historiografik me të dhëna të reja për fillimin e shekulli XX në hapësirën e arealit shqiptar. Libri do të jetë një risi në historiografi dhe autorët meritojnë respekt për punën origjinale për prurjen e fakteve të reja në historiografi.

Kosovar BASHA